

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“LANDI GAS SHOP “ SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 02.12.2020, une i nenshkruari:

1. **Mujo NERGUTI**, i datëlindjes 02.04.1965, lindur ne Kukes dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi G50402194T

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

**“LANDI GAS SHOP “ SHPK**

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

Lagjja 14, Shkozë, Zona Kadastrale 8515, Nr.Pasurie 1/743, Durres

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Për krijimin, instalimin dhe vënien në shfrytëzim sipas kushteve teknike të të gjitha pajisjeve, impianteve, stacioneve, reparteve dhe linjave për ushtrimin e tregimit të hidrokarbureve brenda dhe jashtë shtetit, si vetëm dhe në bashkëpunim me shoqëri të tjera tregtare, persona juridik vendas apo të huaj.
- Import,eksport dhe tregtimin me shumicë e pakicë të teknologjisë dhe pjesëve të këmbimit të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë hidrokarbure duke përfshirë dhe blerjen me qëllim shitje jo vetëm të tyre por edhe të automjeteve të transportit hidrokarbur, të kokave dhe çisternave bote për to dhe për depozita stacionere të bombulave me ose pa mbushje gazi si dhe dhënien e asistencës teknike për vënien në shfrytëzim, kryerjen e çdo servisi teknik për to, si brenda dhe jashtë vendit.
- Ndërtimin dhe vënien në përdorim për vete dhe për të tretë të depove të hidrokarbureve si dhe linjave të pikave të shitjes me shumicë dhe pakicë.
- Import, eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të produkteve industriale, bujqesore e blegtorale.

- Veprimtari në fushën e ndërtimit dhe prodhim inertesh. Agjensi turistike, doganore dhe spedicionere.
- Kontroll teknik i bombolave të gazit, kontroll teknik periodik i pajisjeve nën presion stacionere, kontroll teknik i cisternave metalike të transportueshme për lëndë të rrezikshme.
- Tregti të artikujve të ndryshëm industrialë e ushqimorë, materiale ndërtimi, pajisje e makineri të ndryshme.
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar karburanti e mallrash.
- Ndërtimin e çdo lloji godine, një ose shumëkatëshe sikurse janë komplekset e banimit, qendra biznesi, hotele, bar, restorante, magazina, parkingje, të komplekseve të ndryshme turistike në zona malore e bregdetare, të depove stacionere për karburante e nënprodukteve të tyre dhe kryerje të rikonstruksioneve të tyre.

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **1.000.000** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**MUJO NERGUTI**, është zotërues e 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 1.000.000 leke.

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Mujo NERGUTI**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**MUJO NERGUTI**

